Grant Thornton

An instinct for growth™

Pasqyrat Financiare

Hygeia Hospital Tirana sh.a.

31 dhjetor 2016

Përmbajtja

	Faqe
Raporti i Audituesit të Pavarur	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar	4
Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	5
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	6
Pasqyra e Flukseve të Parasë	7
Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare	8

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr: Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 4 22 74 832
F +355 4 22 56 560
www.grantthornton.al

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e Hygeia Hospital Tirana Sh.a

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Hygeia Hospital Tirana Sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2016, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 dhjetor 2016, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Pasiguri materiale lidhur me vijimësinë e biznesit

Ne tërheqim vëmendjen për Shënim '3.2 Parimi i Vijimësisë' në pasqyrat financiare, ku përshkruhet se Shoqëria ka rezultuar me humbje neto prej 376,361,092 Leke (2015: Humbja neto 542,367,649 Lekë), dhe me 31 dhjetor 2016 detyrimet afatshkurtra tejkalojnë aktivet afatshkurtra me 3,564,986,876 Lekë. Siç thuhet në shënimin 3.2, këto ngjarje ose kushte, së bashku me çështje të tjera, të përcaktuara në Shënimin 3.2, tregojnë se një pasiguri materiale ekziston, e cila mund të shkaktojë dyshim të rëndësishëm në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Opinioni ynë nuk është modifikuar për sa i përket kësaj çështje.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.
Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë proçedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë proçesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
30 mars 2016

Kledion Kadia, FCCA

Grant Thornton Sh.p.k. NIPT K 91923007 M Tirana ALBANIA

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënime	31 dhjetor 2016 Lek	31 dhjetor 2015 Lek
Aktivet			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	6	4,908,531,326	5,210,462,649
Aktivet afatgjata jo-materiale	7	58,475,198	70,552,894
Total i aktiveve afatgjata		**4,967,006,524**	**5,281,015,543**
Aktivet afatshkurtra			
Inventari	8	90,039,396	92,985,096
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	9	135,789,165	127,569,102
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	10	6,078,811	3,391,877
Total i aktiveve afatshkurtra		**231,907,372**	**223,946,075**
Totali i aktiveve		**5,198,913,896**	**5,504,961,618**
Kapitali aksionar			
Kapitali aksionar	11	3,666,306,707	3,666,306,707
(Humbje) të akumuluara		(2,264,287,058)	(1,887,925,966)
Total i kapitalit		**1,402,019,649**	**1,778,380,741**
Detyrimet			
Detyrime afatgjata			
Huatë	12	256,832,840	237,650,511
Total i detyrimeve afatgjata		**256,832,840**	**237,650,511**
Detyrimet afatshkurtra			
Huatë	12	2,501,960,505	2,526,170,982
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	13	1,038,100,902	962,759,384
Total i detyrimeve afatshkurtra		**3,796,894,248**	**3,488,930,366**
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		**5,198,913,896**	**5,504,961,618**

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 25 mars 2017 dhe janë firmosur në emër të tij nga:

Znj. Maria Driva
Drejtor i Përgjithshëm

HYGEIA HOSPITAL-TIRANA SH.A.
Nipt K 71822001 C
Tiranë - Albania

Znj. Enisa Lusha
Drejtor Finance

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 35 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016	2015
		Lek	Lek
Të ardhura operative			
Të ardhura nga shitjet	14	2,729,388,456	2,459,587,955
Të ardhura të tjera	15	25,538,415	33,457,180
Pakësuar me Shpenzimet			
Kosto e materialeve dhe mallrave	16	(653,329,614)	(613,612,038)
Shpenzime personeli	17	(849,965,265)	(805,913,318)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6, 7	(437,841,875)	(563,152,336)
Humbje nga zhvlerësimi	9	(6,558,590)	(1,223,535)
Shpenzime të tjera operative	18	(1,013,424,023)	(942,061,291)
(Humbja) nga operacionet		**(206,192,495)**	**(432,917,383)**
Të ardhurat financiare		41,449,116	79,751,435
Kostot financiare		(211,617,713)	(189,201,601)
Shpenzimet financiare neto	19	**(170,168,597)**	**(109,450,166)**
Humbja para tatim fitimit		**(376,361,092)**	**(542,367,549)**
Tatim Fitimi	20	-	-
(Humbja) neto për vitin		**(376,361,092)**	**(542,367,549)**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			**-**
Humbja totale gjithëpërfshirëse për vitin		**(376,361,092)**	**(542,367,549)**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 35 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali aksionar	Humbje të akumuluara	Totali
Gjendja me 1 janar 2015	**2,550,742,170**	**(1,345,558,416)**	**1,205,183,754**
Rritje e kapitalit	1,115,564,537	-	1,115,564,537
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-
Humbje për vitin	-	(542,367,549)	(542,367,549)
Gjendja me 31 dhjetor 2015	**3,666,306,707**	**(1,887,925,966)**	**1,778,380,741**
Gjendja me 1 janar 2016	**3,666,306,707**	**(1,887,925,966)**	**1,778,380,741**
Rritje e kapitalit	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		-	-
(Humbje) për vitin	-	(376,361,092)	(376,361,092)
Gjendja me 31 dhjetor 2016	**3,666,306,707**	**(2,264,287,058)**	**1,402,019,649**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 35 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Pasqyra e Flukseve të Parasë

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016 Lek	2015 Lek
Aktivitete operative			
Humbja e vitit para tatimit		(376,361,092)	(542,367,549)
Rregullime për:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7	437,841,875	563,152,336
Provizione të llogarive të arketueshme	9	6,558,590	1,223,535
Humbja nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		1,839,085	1,298,018
Provizione të inventarit		10,768,808	13,806,661
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	19	211,617,713	189,201,601
Fitim/(Humbje) operative para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		**292,264,978**	**226,314,602**
Ndryshime në kapitalin qarkullues:			
Inventari	8	(7,954,300)	15,876,364
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	9	(1,661,474)	10,825,162
Llogaritë të pagueshme	13	75,341,518	(38,779,338)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet operative		**357,990,722**	**214,236,790**
Interes i paguar		(200,631,834)	(189,206,583)
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet operative		**157,358,888**	**25,030,207**
Aktivitete investuese			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale	6	(111,877,918)	(160,301,793)
Të hyra nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	6	6,783,313	23,896,907
Blerja e aktiveve afatgjata jo-materiale	7	(21,501,675)	(24,242,790)
Pakësime te aktiveve afatgjata jo-materiale		924,119	-
Flukset monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		**(125,672,161)**	**(160,647,676)**
Aktivitete financuese			
Hyrjet nga qiraja financiare		56,518,054	54,018,829
Ripagimi i qirase financiare		(25,838,375)	(18,224,504)
Ripagimi i Kredise nga palët e lidhura	11	-	146,659,457
(Pagesa)/hyrje neto nga huatë	12	(59,679,472)	(45,780,801)
Flukset monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financuese		**(28,999,793)**	**136,672,981**
Ndryshimi neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		**2,686,934**	**1,055,511**
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fillim të vitit		3,391,877	2,336,366
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në fund të vitit	**10**	**6,078,811**	**3,391,877**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet në faqet 7 deri në 35 të cilat janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave.

Shënimet Shpjeguese për Pasqyrat Financiare

1 Të përgjithshme

"Hygeia Hospital Tirana" Sh.a ("Shoqëria") është themeluar në 2007 dhe regjistruar në Regjistrin Tregtar me Vendimin Nr. 38335 më datë 22 maj 2007. Aktiviteti i saj rregullohet nga nenet e Ligjit Nr. 9901 më datë 14 prill 2008 "Për shoqëritë tregtare". Shoqëria zotërohet nga Diagnostic And Therapeutic Center of Athens Hygeia (me 100%).
Shoqëria është e regjistruar në adresën Kilometri i parë i Rrugës dytësore të Autostradës Tiranë-Durrës, Fushë – Mëzez, Godina Hygeia Hospital Tirana, Kati Përdhes, Seksioni ME.0.11, Kashar, Tiranë.
Aktiviteti i saj kryesor është organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatore të diagnostikimit në territorin e Shqipërisë.
Më 31 dhjetor 2016 numri i punonjësve të shoqërisë ishte 549 (31 dhjetor 2014; 516 Punonjës).

2 Informacioni i përgjithshem dhe deklarata e përputhshmërise me SNRF

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombetare të Kontabilitetit (BSNK) dhe me interpretimet e publikuara ne përputhje me Komitetin e Interpretimeve për Raportimin Financiar ("KINRF") të BSNK.

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike. Baza e matjes për çdo aktiv, detyrim, të ardhur dhe shpenzim është përshkruar në shënimet shpjeguese me detaje.

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve kontabël kritike. Gjithashtu kërkon që drejtimi të ushtrojnë gjykimin e tij në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë. Çështjet të cilat përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose kompleksitetit, apo çështjet ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë paraqitur në shënimin 5: Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në dhe për vitet e mbyllur më 31 Dhjetor 2016 dhe 2015.

2.3 Ndryshimet në politikat kontabël

Politikat e adoptuara të kontabilitetit janë në përputhje me ato të vitit të kaluar financiar.
Ndryshimet që rrjedhin nga përmirësimet në SNRF nuk kanë ndonjë ndikim në politikat kontabël, pozicionin financiar apo në ecurinë e Shoqërisë.

2.3.1 Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016

Shoqëria nuk ka adoptuar standarde të reja apo ndryshime që kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet e Shoqërisë apo pozicionin financiar.
Standardet dhe ndryshimet që janë efektive për herë të parë në vitin 2016 (për subjektet që mbyllen më 31 dhjetor 2016) dhe mund të jenë të zbatueshme për Shoqërinë janë:

• 'Përmirësimet vjetore në SNRF' cikli 2012-2014
• 'Iniciativa për shënimet shpjeguese' (Ndryshimet në SNK 1)
• 'Sqarimi i metodave të pranueshme për zhvlerësimin dhe amortizimin' (Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38)
• 'Bujqësia: Bimët e Bartura' (Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41)
• 'Kontabiliteti për blerjet e interesave në Operacionet e Përbashkëta' (Ndryshimet në SNRF 11)
• 'Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale "(Ndryshimet në SNK 27)
• 'Subjektet e Investimeve: Aplikimi i përjashtimit nga konsolidimi' (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27).

Këto ndryshime nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto pasqyra financiare dhe për këtë arsye nuk është bërë dhënia e informacioneve shpjeguese.

Gjithashtu, SNRF 14 'Llogaritë e shtyra rregullatore "është gjithashtu efektiv nga 1 janari 2016. Megjithatë ky standard aplikohet vetëm për adoptuesit për herë të parë të SNRF dhe për këtë arsye nuk është i zbatueshëm për Shoqërinë.

2.3.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, si dhe ndryshime të standardeve ekzistuese, që ende nuk janë efektive dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria, janë publikuar nga BSNK. Informacion mbi ato standarde që pritet të jenë të rëndësishme për pasqyrat financiare të Shoqërisë është dhënë më poshtë. Drejtimi pret që të gjitha standardet relevante do të miratohen në politikat kontabël të Shoqërisë për periudhën e parë që fillon pas hyrjes në fuqi të shpalljes. Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet të cilat nuk janë miratuar apo të shënuara më poshtë nuk pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SNRF "Instrumentet Financiare" 9
Standardi i ri për instrumentet financiare (SNRF 9) paraqet ndryshime të mëdha në udhezimet e SNK 39 mbi klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare dhe prezanton një model të ri "humbje krediti të pritshme" për zhvlerësimin e aktiveve financiare. SNRF 9 gjithashtu ofron udhëzime të reja për zbatimin e kontabilitetit mbrojtës.

2.3.2 Standardet, amendamentet dhe interpretimet e standardeve ekzistuese që nuk janë ende në fuqi dhe nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria - vazhdim

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e SNRF 9, por nuk është ende në gjendje për të dhënë informacion sasior. Në këtë fazë fushat kryesore të ndikimit të pritshëm janë si më poshtë:

- klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare të Shoqërisë do të duhet të shqyrtohen në bazë të kritereve të reja të cilat konsiderojnë flukset monetare kontraktuale të aktiveve dhe modelin e biznesit në të cilën ato janë administruar.
- një zhvlerësim i pritshëm me bazë humbje krediti do të duhet të njihet në të arkëtueshmet tregtare të Shoqërisë, nëse nuk klasifikohen me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me kriteret e reja.

Ndryshimet në vlerën e drejtë do të paraqitet në fitim ose humbje, përveç rasteve kur Shoqëria bën një përcaktim të pakthyeshëm për të paraqitur ato në të ardhura të tjera përmbledhëse.
SNRF 9 do të hyjë në fuqi për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018.

SNRF 15 "Të ardhurat nga kontratat me klientët"
SNRF 15 paraqet kërkesat e reja për njohjen e të ardhurave, duke zëvendësuar SNK 18 'Të ardhurat', 'SNK 11 Kontratat e ndërtimit', dhe disa Interpretime të lidhura me të ardhurat. Standardi i ri krijon një model njohjeje me bazë kontrolli të ardhurave dhe jep udhëzime shtesë në shumë fusha që nuk mbulohen në mënyrë të detajuar nga SNRF-ve ekzistuese, duke përfshirë mënyrën për njohjen e marrëveshjeve me detyrime të shumta të performancës, çmime të ndryshueshme, të drejtat e rimbursimit të konsumatorit, furnizuesi opsione e riblerjes nga furnizuesit, dhe kompleksitete të tjera të zakonshme.

Drejtimi ka filluar të vlerësojë ndikimin e Standardit të ri.
SNRF 15 hyn në fuqi në periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018.

SNRF 16 "Qiratë"
SNRF 16 do të zëvendësojë SNK 17 dhe tre Interpretimet përkatëse. Kjo kompleton projektin e gjatë e BSNK-së për të rishikuar të kontabilitetin e qirave. Qiratë do të regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar në formën e një të drejte përdorimi të një aktivi dhe të një detyrimi qiraje.
SNRF 16 hyn në fuqi në periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2019. Drejtimi është ende duke vlerësuar ndikimin e plotë të Standardit dhe për këtë arsye nuk është në gjendje të japë informacion sasior. Megjithatë, për të përcaktuar ndikimin Shoqëria është në proces të:

- kryerjes së një rishikimi të plotë të të gjitha marrëveshjeve dhe për të vlerësuar nëse ndonjë kontratë shtesë tani do të bëhet një qira sipas përkufizimit të ri SNRF 16
- përcaktimit të dispozitave kalimtare që do të miratojë; aplikimin e plotë retrospektiv ose aplikimin e pjesshëm retrospektiv (që do të thotë informacioni krahasues nuk duhet të riparaqitet). Aplikimi i metodës së pjesshme jep gjithashtu një opsion lehtësimi për rivlerësimin nëse kontratat ekzistuese janë, ose përmbajnë, një qira, si edhe lehtësime të tjera. Përcaktimi se cilët nga këto praktika do të miratohen është i rëndësishëm pasi ato janë zgjedhje të pakthyeshme
- vlerësimit të informacioneve shpjeguese të saj aktuale për qiratë financiare dhe qirave operative pasi këto kanë të ngjarë të formojnë bazën e shumave që do të kapitalizohen dhe të bëhen të drejta përdorimi të aseteve
- përcaktimin se cilat thjeshtëzime opsionale kontabël do të zbatohen për portofolin e tyre të qirasë dhe nëse se do të përdoren përjashtime
- vlerësimit të sistemit të IT dhe nëse nevojitet një sistem të ri leasing. Kjo është duke u konsideruar në përputhje me zbatimin e SNRF 15 dhe SNRF 9 në mënyrë që Shoqëria vetëm t'i nënshtrohet një sërë ndryshimesh të sistemit njëhkohësisht
- vlerësimit për dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë që do të nevojiten.

Shoqëria ka zgjedhur të mos miratojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre.

3 Përmbledhje e politikave kontabël

Politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë të paraqitura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitur, nëse nuk shprehet ndryshe.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

(a) Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë paraqitur në Lekë Shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha funksionale e shoqërisë. Përveç rasteve kur është shprehur ndryshe, informacioni financiar është paraqitur në Lekë.

(b) Transaksionet dhe balancat ne monedhe te huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kurset e këmbimit në datën e transaksioneve. Të gjitha humbjet dhe fitimet nga kursi i këmbimit që rezultojnë nga kryerja e këtyre transaksioneve dhe nga rivlerësimi i zërave monetare në monedhë të huaj me kursin e këmbimit të fundit të vitit njihen në fitim ose humbje.

Zërat jo-monetare nuk ri këmbehen në fund të periudhës dhe maten me kosto historike pëkthehen ne lekë duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është kryer transaksioni), përveç rasteve kur zërat jo-monetare maten me vlerë të drejtë të cilat këmbehen duke përdorur kurset e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset zyrtare të aplikuara (Lekë kundrejt monedhave të tjera të huaja) për monedhat kryesore me 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

Kurset e këmbimit të rëndësishme në drejtim të Lekut Shqiptar për 1 njësi të monedhës së huaj në datën e raportimit janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Njësia monetare e Bashkimit Europian (EUR)	135.23	137.28
Dollari Amerikan (USD)	128.17	125.79

3.2 Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në bazë të parimit të vijimësisë, i cili supozon që shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj operacionale për periudhën e ardhshme të parashikueshme. Gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2016 shoqëria ka rezultuar me humbje neto prej 376,361,092 Leke (2015: Humbja neto 542,367,649 Lekë), dhe me 31 dhjetor 2016 detyrimet afatshkurtra tejkalojnë aktivet afatshkurtra me 3,564,986,876 Lekë.

Pamundesia e shoqërisë në përmbushjen e kushteve të marrëveshjes së huasë dhe nevojave financiare, humbjet e saj të përsëritura nga operacionet, si dhe pozita negative e kapitalit punues mund të hedhin dyshime në lidhje me aftësinë e shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Aftësia e shoqërisë për të përmbushur detyrimet dhe për të vazhduar në vijimësi varet nga fondet e marra nga shoqëria mëmë. Shoqëria mëmë është angazhuar të vazhdojë të sigurojë mbështetje financiare për shoqërinë për një periudhë prej së paku 12 muaj nga data e letrës mbështetëse. Drejtimi beson se po merr të gjitha masat e nevojshme për të mbështetur qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë në rrethanat e tanishme.

Shoqëria gjatë vitit 2016 ka pasur një rritje në të ardhurat e saj me 11% (2015 - 29%). Humbja neto e vitit është reduktuar me 30% krahasuar me vitin e kaluar. Gjithashtu Shoqëria ka gjeneruar një fluks pozitiv prej 292,264,978 lekë nga aktivitetet operative përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues.

Efektet e krizës globale financiare në industri mund të rezultojnë në një ulje të mëtejshme të mjeteve monetare të gjeneruara nga operacionet.
Debitorët ose huamarrësit e shoqërisë mund të ndikohen gjithashtu nga situata e likuiditetit të ulët, e cila nga ana tjetër mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të ri-paguar shumat që detyrohen. Drejtimi i shoqërisë nuk është në gjendje të parashikoje të gjitha zhvillimet që mund të kenë një ndikim në sektorin e ekonomisë dhe më gjerë, dhe rrjedhimisht çfarë efekti do të kenë (nëse do të kenë) në pozicion financiar të shoqërisë në të ardhmen.

3.3 Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Elementet e aktiveve afatgjata materiale mbahen me kosto historike pakësuar zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë, nëse ka.

Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet që i atribuohen drejtpërdrejtë blerjes së aktivit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin kostot e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër të atribueshme për sjelljen e aktivit në kushte pune për përdorimin e destinuar të tij, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktivit si dhe rregullimin e vendit në të cilin ishte vendosur aktivi dhe kapitalizimin e kostove të huamarrjes.

Në rastet kur elementet e një aktivi material afatgjatë kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato mbahen si aktive afatgjata materiale më vete (komponentët kryesore) .

(ii) Kostot e mëpasshme

Kosto e zëvendësimit të pjesëve të aktiveve afatgjata materiale i shtohet vlerës së mbartur të aktivit vetëm në qoftë se parashikohet që kjo pjesë të sjellë përfitime ekonomike në të ardhmen për shoqërinë dhe kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të aktiveve materiale afatgjata njihen në shpenzimet e periudhës kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi ngarkohet në fitim ose humbje të vitit sipas metodës lineare duke u bazuar në normat të cilat i përafrohen jetës mesatare të dobishme ekonomike të aktiveve afatgjata materiale. Toka nuk zhvlerësohet. Jeta e dobishme ekonomike e vlerësuar për aktivet afatgjata materiale paraqitet si më poshtë:

Ndërtesa	50 vjet
Makineri	5-8 vjet
Mjete transporti	5-8 vjet
Mobilie dhe orendi	5 vjet

Vlera e mbetur dhe jetëgjatësia e aktiveve afatgjata materiale rishikohet, dhe rregullohet nëse është e përshtatshme, në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar. Vlera kontabël e një aktivi shpenzohet menjëherë deri në vlerën e rikuperueshme, nëse vlera kontabël e aktivit është më e madhe se shuma e vlerësuar e rikuperueshme. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël. Këto janë të përfshira në fitimin ose humbjen e periudhës financiare.

3.4 Aktivet afatgjata jo-materiale

Aktivet afatgjata jo-materiale të blera nga shoqëria paraqiten me kosto historike minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga rënia në vlerë (nëse ka), bazuar në jetëgjatësinë e vlerësuar pas datës së cilës ato janë të gatshme për përdorim. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata jo-materiale varion nga 3 deri në 10 vjet. Jetëgjatësia dhe metoda e amortizimit të aktiveve afatgjata jo-materiale rishikohet, në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar dhe efektet e ndryshimit merren parasysh në periudhat e ardhshme.

3.5 Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të vogël midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e çmuara të përfundimit dhe kostot e çmuara që duhen për realizimin e shitjes.
Kostot e inventarit përcaktohen duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar , e cila përfshin të gjitha kostot e blerjes, transportit, tarifat doganore dhe sigurimit gjatë transportit, kostot e konvertimit dhe çdo kosto tjetër që lidhet me inventarin për të sjellë atë në vendin dhe kushtet e punës.

3.6 Instrumentet financiare

Një aktiv apo detyrim financiar njihet kur shoqëria behet pjesë e një provigjionimi kontraktual në lidhje me instrumentin financiar dhe fillimisht maten me vlerë të drejtë pakësuar me kostot e transaksionit, përveç instrumenteve që mbahen me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes të cilat fillimisht maten me vlerë të drejtë dhe kostot e transaksionit kalojnë në fitim ose humbje.

Aktivet financiare

Shoqëria klasifikon instrumentet financiarë të saj sipas kategorive të mëposhtme në: aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, kredi dhe llogari të arkëtueshme, aktive financiarë të mbajtur deri në maturim dhe aktive financiare te vlefshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin investimet janë blerë. Drejtimi përcakton klasifikimin e investimeve në njohjen fillestare dhe kur është nevojshme ri-vlerëson këtë përcaktim në çdo datë raportimi.

(a) Aktive financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori të tjera: aktive financiare të mbajtura për tregtim dhe aktive të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes që në njohjen fillestare.

Një aktiv financiar klasifikohet në kategorinë "aktiv financiar me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes" që në njohjen fillestare nëse është blerë me qëllimin e shitjes brenda një periudhe afatshkurtër, nëse është pjesë e një portofoli aktivesh financiare për të cilin ka një evidencë për qëllime fitimesh afatshkurtra, ose nëse përcaktohet si i tillë nga drejtimi i shoqërisë. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

(b) Kredi dhe llogari të arkëtueshme

Kredi dhe llogari të arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuara në tregje aktive përveç atyre aktiveve që shoqëria synon ti shesë brenda një periudhe afatshkurtër ose i ka përcaktuar si aktive me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjonin për zhvlerësim.

Provigjoni për zhvlerësimin e kredive dhe të drejtave të tjera të arkëtueshme krijohet kur ka një evidencë objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, llogaritë e arkëtueshme dhe pjesa më e madhe e llogarive të tjera të arkëtueshme bëjnë pjesë në këtë kategori të aktiveve financiare.

(c) Aktive financiare të mbajtura deri në maturim

Investime financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme përveç atyre që përmbushin përkufizimin e kredive dhe të tjera të arkëtueshme dhe për të cilat shoqëria ka qëllimin dhe mundësinë për ti mbajtur ato deri në maturim. Këto aktive njihen në fillim me vlerë të drejtë dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjonin për zhvlerësim, nëse ka. Një provigjion për zhvlerësimin e instrumenteve të borxhit të mbajtur deri në maturim krijohet nëse ka një evidencë objektive që shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat sipas kushteve fillestare. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në këtë kategori në datën e raportimit.

(d) Aktive financiare të vlefshme për shitje

Aktivet financiare të vlefshme për shitje janë aktive financiare jo-derivative të cilat përcaktohen si të tilla në këtë kategori ose që nuk janë klasifikuar në asnjë kategori tjetër. Shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara ne këtë kategori në datën e raportimit.

Çregjistrimi

Aktivet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale për arkëtime nga instrumentet financiare kanë skaduar ose janë transferuar dhe kur shoqëria transferon të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë.

Matja e mëpasshme

Aktivet financiare të vlefshme për shitje dhe aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes mbahen me vlerë të drejtë. Kreditë dhe të drejtat e tjera të arkëtueshme dhe aktivet e tjera të mbajtura deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të parealizuara që lindin si rezultat i ndryshimeve në vlerën e drejtë të aktiveve financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes përfshihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në periudhën kur lindin.

Fitimet dhe humbjet e parealizuara që vijnë si rezultat i ndryshimeve në vlerën e drejtë të investimeve jo-monetare të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në te ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe paraqiten në rezerva.
Kur letrat me vlerë të klasifikuara si aktive financiare për shitje janë shitur ose janë përcaktuar për tu zhvlerësuar, fitimet ose humbjet kumulative të njohura në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse riklasifikohen nga rezervat tek fitimi ose humbja dhe paraqiten si një rregullim riklasifikues tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Interesi nga aktivet financiare të vlefshme për shitje llogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihet në të ardhura ose shpenzime. Dividendët nga aktivet financiare të vlefshme për shitje janë njohur në pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve kur e drejta e shoqërisë për të marrë pagesa është përcaktuar. Të dy rastet e mësipërm janë përfshire në zërin e të ardhurave nga investimet.

Vlera e drejtë e aktiveve të kuotuara është bazuar në çmimet e ofertës aktuale. Në qoftë se tregu për një aktiv financiar nuk është aktiv, shoqëria e përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve në kushte tregu, referenca për instrumente të tjera që janë në thelb te njëjta, analiza e skontimit te flukseve monetare, etj.

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare të shoqërisë përfshijnë huatë dhe llogaritë e pagueshme. Detyrimet financiare janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë pakësuar me kostot e transaksionit të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e tyre. Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar dhe çdo diference midis kostos dhe vlerës së kompensimit njihet në fitim ose humbje përgjatë periudhës së detyrimit financiar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Netimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare raportohen të netuara në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjërisht e zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për t'i mbajtur ato mbi bazë neto, ose te njohësh aktivin dhe të shlyesh detyrimin në të njëjtën kohë.

3.7 Zhvlerësimi

Zhvlerësimi i aktiveve financiare të mbajtura me kosto të amortizuar

Në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar, shoqëria vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare është zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare zhvlerësohet dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen vetëm nëse ekzistojnë prova objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të një aktivi (një 'ngjarje humbje') dhe ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka ndikim në flukset e ardhshme te vlerësuara të aktivit financiar ose te një grupi aktivesh financiare që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Tregues objektiv që një aktiv financiar ose grup aktivesh është zhvlerësuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme që vijnë në vëmendjen e shoqërisë në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

a) Vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose të debitorit;

b) Shkelja e kontratës, si vonesa në pagesa e penalitete;

c) Mundësia që emetuesi ose debitori do të hyjë në proces falimentimi ose riorganizime të tjera financiare;

d) Zhdukja e një tregu aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare, ose;

e) Të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve te ardhshme monetare nga një grup i aktiveve financiare që nga njohja fillestare e tyre, megjithëse rënia ende nuk mund të identifikohet specifikisht me një aktiv financiar të shoqërisë, duke përfshirë:

   - Ndryshimet jo te favorshme në statusin e pagesës së emetuesit ose të debitorit në shoqëri, ose
   - Kushte ekonomike kombëtare apo lokale që lidhen me mos pagesën e aktivit të shoqërisë.

Në fillim, shoqëria konsideron nëse ekzistojnë evidenca objektive individuale të zhvlerësimit për aktivet financiare dhe janë individualisht të konsiderueshme. Nëse shoqëria përcakton se nuk ka evidenca objektive të zhvlerësimit për një aktiv financiar të testuar individualisht, i konsiderueshëm apo jo, e bashkon aktivin në një grup aktivesh financiare me rrezik krediti të njëjtë dhe në mënyrë kolektive i teston për zhvlerësim. Aktivet që janë të testuara në mënyrë individuale dhe për të cilat një humbje nga zhvlerësimi ekziston ose vazhdon të njihet nuk bashkohen me aktivet e tjera që testohen në mënyrë kolektive.

Nëse ekziston evidencë objektive që një humbje nga zhvlerësimi është krijuar për huatë dhe të arkëtueshmet ose nga aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet që mbahen me kosto të amortizuar, shuma e humbjes matet si diference midis vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që kanë ndodhur) të skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar. Vlera kontabël e aktivit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie rezerve, dhe shuma e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje. Nëse një investim i mbajtur deri ne maturim ose një hua ka një normë të ndryshueshme të interesit, norma e skontimit për matjen e zhvlerësimit është norma aktuale efektive e interesit e përcaktuar sipas kontratës

Si praktike e njohur, shoqëria mund të masë zhvlerësimin e një instrumenti financiar në bazë të vlerës së drejtë duke përdorur një çmim të vëzhguar të tregut. Për qëllim të testimit kolektiv për zhvlerësim, aktivet financiare grupohen sipas karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kreditit (p.sh., në bazë të procesit të vlerësimit të shoqërisë që konsideron llojin e aktivit, industrinë, pozicionin gjeografik, statusin e pagesave, dhe faktorë të tjerë të lidhur).Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të tilla aktivesh duke qenë tregues i aftësisë së emetuesit për të paguar të gjitha shumat sipas kushteve kontraktuale të instrumentit të borxhit nën vlerësim.

Në qoftë se në një periudhë të mëvonshme, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pasi zhvlerësimi ishte njohur (të tilla si përmirësimi i indeksit te kreditit), humbja e njohur më parë nga zhvlerësimi ndryshohet duke rregulluar llogarinë e rezervës. Shuma e ndryshimit njihet ne pasqyrën e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të shoqërisë përveç inventarëve dhe aktivit tatimor të shtyrë rishikohet çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Vlera e rikuperueshme e aktivit vlerësohet kur ka të dhëna të tilla. Humbja nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbartur e një aktivi apo e njësisë së tij gjeneruese të flukseve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Një njësi gjeneruese mjetesh monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare të cilat janë të pavarura në mënyrë të konsiderueshme nga aktive apo grupe të tjera. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. lera e rikuperueshme e një aktivi apo njësie gjeneruese është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe vlerës së tij të drejtë pas zbritjes së kostove të shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë zbritjeje para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të aktivit.

Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për ekzistencën e treguesve të një rënie apo eliminimi të zhvlerësimit. Humbja e zhvlerësimit rimerret nëse ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e rikuperueshme. Humbja e zhvlerësimit rimerret deri në masën që vlera e mbetur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbetur që do të ishte përcaktuar, pas zbritjes së amortizimit, nëse nuk do të ishte njohur asnjë humbje zhvlerësimi.

3.8 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar konsiston në mjetet monetare të kontribuara nga themeluesit e shoqërisë. Kapitali aksionar paraqitët me vlerën në Lekë të konvertuar me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksionar i shoqërisë njihet me vlerë nominale.

3.9 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet 3 ose më pak muaj, për të cilat rreziku i një ndryshimi në vlerën e drejtë është i pakonsiderueshëm, investime të cilat shoqëria i përdor për menaxhimin e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre të amortizuar.

3.10 Njohja e te ardhurave

Të ardhurat përfshijnë të ardhurat nga shitja e mallrave dhe kryerja e shërbimeve. Të ardhurat nga produktet dhe shërbimet kryesore paraqiten në shënimin 14.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të parave të marra ose të arkëtueshmeve nga shoqëria për mallrat e dhëna ose shërbimet e kryera, duke përjashtuar taksat e shitjes, rabatet, dhe uljet tregtare. Shoqëria aplikon kriteret e njohjes së të ardhurave të përcaktuara si më poshtë tek çdo komponent i veçantë i transaksionit të shitjes në mënyrë që të reflektoje thelbin e transaksionit. Të ardhurat e marra nga këto transaksione janë alokuar tek komponentët e veçantë te identifikuar duke patur parasysh vlerën relative të drejtë të çdo komponenti.

Të ardhurat njihen kur vlera e të ardhurave mund të matet me besueshmëri, mbledhja është e mundshme, kostoja e ndodhur ose që do të ndodhë mund te matet me besueshmëri, dhe kur kriteret për çdo aktivitet të ndryshëm të shoqërisë janë plotësuar. Këto kritere njohje specifike për çdo aktivitet janë bazuar në mallra dhe zgjidhje të dhëna klientit dhe në kushtet e kontratës për çdo rast dhe përshkruhen më poshtë:

Shitja e mallrave – me pakicë

Shitja e mallrave njihet kur produktet i shiten konsumatorit. Shitjet me pakicë bëhen zakonisht me para ose me kartë krediti.

Ofrimi i shërbimeve

Të ardhurat nga shitja e shërbimeve do të njihen në periudhën në të cilën shërbimet ofrohen, duke iu referuar fazës së realizimit të tyre në qoftë se një gjë e tillë mund të matet në mënyrë me besueshmëri.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurime shoqërore

Gjatë ushtrimit të aktivitetit operativ, shoqëria kryen pagesa periodike për llogari të punonjësve për pjesën që ligjërisht i takon të paguajë shoqërisë dhe punonjësve për të kontribuar për fondet e detyrueshme të pensioneve sipas rregullimeve të legjislacionit vendas. Kostot e shoqërisë janë përfshirë në llogaritjen e rezultatit të periudhës.

3.12 Tatim fitimi i vitit dhe tatim fitimi i shtyrë

Shpenzimet për tatim fitimin përfshijnë tatim fitimin aktual dhe tatim fitimin e shtyrë. Shpenzimet për tatim fitimin njihen në fitim ose humbje përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse .
Tatimi mbi fitimin aktual është tatimi i pagueshëm mbi të ardhurat e tatueshme duke përdorur normat e taksimit në datën e raportimit dhe çdo rregullim i tatimit të pagueshëm te lidhur me vitin e kaluar. Tatimi mbi fitimin i aplikueshëm është 15% e fitimit të tatueshëm.

Tatim fitimi i shtyre njihet në lidhje me diferencat e përkohshme midis vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyre matet me normat tatimore që pritet të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato ndryshojnë, duke u bazuar në ligjet që kanë qenë ose janë në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyre njihet ne masën që është e mundur qe fitime te ardhshme te tatueshme do të jenë në dispozicion për të mbuluar diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore te shtyra rishikohen në çdo date raportimi dhe reduktohen në qoftë se përftimet tatimore nuk do të jenë më të mundshme për tu realizuar.

3.13 Provigjonet

Provigjonet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një rrjedhje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të jetë e nevojshme për të shlyer detyrimin dhe kur një vlerësim i besueshëm i vlerës së detyrimit mund të bëhet. Nëse efekti është material, provigjonet llogariten duke zbritur vlerën e pritshme të mjeteve monetare të ardhshme para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë, dhe kur është e nevojshme rrezikun specifik të detyrimit.
Provigjonet rishikohen ne çdo datë raportimi dhe nëse nuk është më e mundshme që një dalje e burimeve që përfshijnë përftime ekonomike do te kërkohet për të shlyer detyrimin, provigjoni anulohet. Provigjonet përdoren vetëm për qëllimet e njohura fillimisht. Provigjonet nuk njihen për humbje të ardhme operative. Angazhimet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në kontabilitet.

3.14 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e daljes së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet shpjeguese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme. Shuma e një humbje të kushtëzuar njihet si provigjion nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë provigjonin, një detyrim njihet ne datën e Pasqyrës e pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet ne mënyrë të besueshme.

3.15 Transaksione me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionarë dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme , vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm formës ligjore.

3.16 Ngjarjet pas datës se raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e pasqyrës se pozicionit financiar (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

4 Menaxhimi i rrezikut financiar

4.1 Faktorët e rrezikut financiar

Aktivitetet e shoqërisë e ekspozojnë atë ndaj një shumëllojshmërie rreziqesh financiare, që përfshijnë rrezikun e kreditit dhe rrezikun e lidhur me efektet e ndryshimit në kursin e këmbimit të monedhave të huaja dhe normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të shoqërisë fokusohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe synon të minimizoje efektet potenciale të kundërta mbi performancën e biznesit të shoqërisë.

Menaxhimi i rrezikut kryhet nga drejtimi bazuar në politika të aprovuara dhe procedura që mbulojnë gjithë menaxhimin e rrezikut, si dhe çështje specifike, si rreziku i kursit të këmbimit, rreziku i normës se interesit, rreziku i kreditit, përdorimi i letrave me vlerë të përshtatshme dhe investimi i likuiditetit të tepërt.

4.2 Rreziku i tregut

Rreziku i kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit që vjen si rezultat i ekspozimit në monedha të ndryshme kryesisht në lidhje me Euro-n. Shoqëria nuk përdor ndonjë instrument për tu mbrojtur ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për të mbajtur pozicione neto të përshtatshme në çdo monedhë dhe në total dhe të monitorojë operacionet e përditshme.

Vlera kontabël e aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të shprehura në monedhë të huaj është si më poshtë:

		31 dhjetor 2016 Në Lekë	**31 dhjetor 2015** Në Lekë
Aktive			
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	EUR	1,512,082	660,840
		1,512,082	**660,840**
Detyrime			
Huatë	EUR	2,758,793,345	2,763,821,493
Llogaritë e pagueshme në monedhë të huaj	EUR	435,630,901	378,666,065
		3,194,424,247	**3,142,487,557**
Hendeku i kursit të këmbimit		**(3,192,912,164)**	**(3,141,826,718)**

Analiza e ndjeshmërisë së monedhës së huaj

Në Lekë			**2016**
	Shuma neto	**10%**	**(10%)**
EUR	(3,192,912,164)	(319,291,216)	319,291,216
			2015
	Net amount	**10%**	**(10%)**
EUR	(3,141,826,718)	(314,182,672)	314,182,672

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit, dhe një korrelacion të vlerave të tyre për një 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Përqindja është përcaktuar duke u bazuar në paqëndrueshmërinë e tregut në kursin e këmbimit në 12 muajt e mëparshëm.

Flukset monetare dhe rreziku i vlerës së drejtë të normës së interesit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj ndikimeve që luhatjet në nivelet e normës së interesit që mbizotërojnë në treg kanë në bilancin kontabël dhe flukset e saj të parasë. Drejtimi i shoqërisë është përgjegjës për monitorimin ditor të pozicionit të rrezikut të normës neto të interesit dhe vendos limite për të reduktuar ndikimin e luhatjes të normës së interesit. Luhatjet e normës së interesit të tregut me të cilën janë marrë fonde hua mund të kenë efekt negativ në performancën financiare të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, shoqëria nuk ka vendosur aktive të shumta në depozita me afat dhe në letra me vlere shumë likuide, duke përfituar të ardhura interesi shtesë.

	31 dhjetor 2016 Në Lekë	**31 dhjetor 2015** Në Lekë
Aktive financiare		
Që nuk mbartin interes		
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	103,997,163	97,846,055
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	2,098,834	1,377,128
	106,095,997	**99,223,183**
Me norma interesi fikse		
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre	3,979,977	2,014,749
	3,979,977	**2,014,749**
	110,075,973	**101,237,932**
Detyrime financiare		
Që nuk mbartin interes		
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	1,006,844,017	925,290,196
Huatë nga palet e lidhura	191,079,990	193,976,640
	1,197,924,007	**1,119,266,836**
Me norma interesi të ndryshueshme		
Huatë që mbartin interes	2,501,960,505	2,526,170,982
	2,501,960,505	**2,526,170,982**
	3,699,884,512	**3,645,437,817**

Analiza e ndjeshmërisë e normave të interesit

Në Lekë			**2016**
	Shuma neto	**2%**	**(2%)**
Me norma interesi variabël	2,501,960,505	50,039,210	50,039,210
			2015
	Net amount	**2%**	**(2%)**
	(2,526,170,982)	(5,052,342)	5,052,342

Shumat pozitive/negative tregojnë rritje/ulje në fitime ose në kapitale të tjera, të cilat ndodhin kur normat e interesit janë më të larta/më të ulëta se 2%.

4.3 Rreziku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes financiare për shoqërinë nëse klientët ose palët e tjera nuk përmbushin detyrimet kontraktuale dhe lind kryesisht nga llogaritë e arkëtueshme të shoqërisë. Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është kryesisht i influencuar nga karakteristikat individuale të çdo klienti. Shoqëria krijon një fond provigjoni për zhvlerësim i cili përfaqëson vlerësimet e shoqërisë për humbjet e ndodhura në lidhje me llogaritë e arkëtueshme bazuar tërësisht në humbjet specifike të lidhura me ekspozime individualisht të rëndësishme.

Ekspozimi maksimal i shoqërisë ndaj rrezikut të kreditit është përfaqësuar nga vlerat kontabël të çdo aktivi financiar në pasqyrën e pozicionit financiar të përmbledhura si më poshtë:

	31 dhjetor 2016 Në Lekë	31 dhjetor 2015 Në Lekë
Klasat e aktiveve financiare – vlerat kontabël:		
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	6,078,811	3,391,877
Llogarite e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	103,997,163	97,846,055
Totali	**110,075,973**	**101,237,932**

Në datën e raportimit cilësia e kreditit për llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të ardhura të shoqërisë paraqitet në Shënimin 9.

4.4 Rreziku i likuiditetit

Shoqëria menaxhon nevojat e saj për likuiditet duke monitoruar me kujdes pagesat e skeduluara të borxhit që rezultojnë nga detyrimet financiare si dhe parashikon hyrjet dhe daljet monetare në biznesin e përditshëm. Nevojat për likuiditet monitorohen në kohë të ndryshme. Kërkesat neto për para krahasohen me huamarrjet e disponueshme në mënyrë që të përcaktohet çdo mungesë. Kjo analizë tregon nëse huamarrjet e disponueshme priten të jenë të mjaftueshme gjatë periudhës së vëzhguar. Shoqëria mban para për të përballuar kërkesat për likuiditet për një periudhë minimalisht prej 30 ditësh. Shoqëria ka mbështetje të vazhdueshme nga shoqëria mëmë përmes huave që sigurojnë menaxhimin e likuiditetit si dhe financim të jashtëm nga bankat.

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, aktivet dhe detyrimet financiare të shoqërisë kanë maturitete kontraktuale (përfshirë pagesat e interesit kur aplikohen) si më poshtë:

	Afatshkurtra	Afatgjata			
Më 31 dhjetor 2016	**1 deri 12 muaj**	**1 deri 2 vjet**	**2 deri 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Totali**
Llogari tregetare dhe te tjera te arketueshme	135,789,165	-	-	-	135,789,165
Mjete monetare	6,078,811	-	-	-	6,078,811
	141,867,976	**-**	**-**	**-**	**141,867,976**
Llogari tregetare dhe te tjera te pagueshme	(1,006,844,017)	-	-	-	(1,006,844,017)
Hua	(2,501,960,505)	(21,593,586)	(44,159,264)	(191,079,990)	(2,758,793,345)
	(3,508,804,522)	**(21,593,586)**	**(44,159,264)**	**(191,079,990)**	**(3,765,637,363)**
Risku i likuiditetit ne 31 dhjetor 2016	**(3,366,936,546)**	**(21,593,586)**	**(44,159,264)**	**(191,079,990)**	**(3,623,769,387)**

	Afatshkurtra	Afatgjata			
Më 31 dhjetor 2015	**1 deri 12 muaj**	**1 deri 2 vjet**	**2 deri 5 vjet**	**Mbi 5 vjet**	**Totali**
Llogari tregetare dhe te tjera te arketueshme	127,569,101	-		-	127,569,101
Mjete monetare	3,391,877	-	-	-	3,391,877
	130,960,978	**-**	**-**	**-**	**130,960,978**
Llogari tregetare dhe te tjera te pagueshme	(925,290,196)	-	-	-	(925,290,196)
Hua	(2,526,170,982)	(13,204,405)	(30,469,514)	(193,976,640)	(2,763,821,540)
	(3,451,461,177)	**(13,204,405)**	**(30,469,514)**	**(193,976,640)**	**(3,689,111,736)**
Risku i likuiditetit ne 31 dhjetor 2015	**(3,320,500,199)**	**(13,204,405)**	**(30,469,514)**	**(193,976,640)**	**(3,558,150,758)**

4.5 Menaxhimi i rrezikut të kapitalit

Objektivat e shoqërisë në menaxhimin e kapitalit janë të ruajë aftësinë e shoqërisë për të vazhduar biznesin në vijimësi në mënyrë që të sigurojë përfitime për aksionaret dhe përfitime për palët e tjera të interesuara dhe të mbajë një strukture optimale kapitali për të reduktuar koston e kapitalit.

Raporti borxh/kapital

Struktura e kapitalit të shoqërisë përbëhet nga detyrime dhe kapital, që përbëhet nga kapitali i pronareve dhe humbjet e akumuluara. Drejtimi rishikon strukturën e kapitalit në terma vjetore si një lidhje ndërmjet detyrimeve për huatë dhe totalit të kapitalit.

Treguesit e borxhit në fund te vitit janë si më poshtë:

	2016	**2015**
Huatë	2,758,793,345	2,763,821,493
Kapitali aksionar	3,666,306,707	3,666,306,707
Hua/Kapital	0.75	0.75

4.6 Vlerësimi me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson vlerën me të cilën një aktiv mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në kushtet e tregut. Vlera e drejtë është bazuar në supozimin e drejtimit në përputhje me profilin e bazës së aktivit dhe të detyrimit.

4.6.1 Instrumentet financiare të prezantuar me vlerë të drejtë

Aktivet financiare të matura me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar janë në përputhje me hierarkinë e vlerës së drejtë e cila i grupon aktivet dhe detyrimet financiare në tre nivele bazuar në rëndësinë e të dhënave të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aktiveve financiare. Hierarkia e vlerës së drejtë është si vijon:

- **Niveli 1**: çmimet e kuotuara (të pakorrigjuara) në tregjet aktive për aktive ose detyrime financiare të ngjashme;
- **Niveli 2**: të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuara të përfshira në Nivelin 1 që janë të disponueshme për aktivet dhe detyrimet e observuara, direkt (p.sh. çmimet) ose indirekt (të dhëna nga çmimet) dhe
- **Niveli 3**: të dhëna mbi aktivet dhe detyrimet që nuk janë të bazuar në të dhëna të disponueshme nga observimi i tregut

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 shoqëria nuk ka aktive të klasifikuara në asnjë nga kategoritë e mësipërme.

4.6.2 Instrumente financiare që nuk janë prezantuar me vlerë të drejtë

Tabela në vijim tregon një përmbledhje të vlerave kontabël neto dhe vlerave të drejta të atyre aktiveve financiare dhe detyrimeve që nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar me vlerën e tyre të drejtë:

Në Lekë	Vlera kontabël		Vlera e drejtë	
	2016	**2015**	**2016**	**2015**
Aktive financiare				
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arketueshme	103,997,163	97,846,055	103,997,163	97,846,055
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	6,078,811	3,391,877	6,078,811	3,391,877
Totali i aktiveve financiare	**110,075,973**	**101,237,932**	**110,075,973**	**101,237,932**
Detyrime financiare				
Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	1,006,844,017	925,290,196	1,006,844,017	925,290,196
Huatë	2,758,793,345	2,763,821,493	2,758,793,345	2,763,821,493
Totali i detyrimeve financiare	**3,765,637,363**	**3,689,111,689**	**3,765,637,363**	**3,689,111,689**

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme

Kreditë dhe llogaritë e arkëtueshme janë mbajtur me kosto të amortizuar, minus provizionet për zhvlerësim. Vlera e tyre korrespondon me vlerën e tyre kontabël për shkak të maturitetit afat shkurtër.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Vlera e drejtë e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre konsiderohet të jetë e përafërt me vlerat respektive kontabël si pasojë e maturimit te tyre më të shkurtër se tre muaj.

Llogari dhe hua të pagueshme

Vlerat kontabël të llogarive të pagueshme dhe huave të pagueshme përafrohen me vlerën e tyre të drejtë për shkak të maturitetit afat shkurtër. Huatë me norma interesi variable përafrohen me vlerën e tyre të drejtë për shkak të faktit që normat variable të interesit konsiderohen si norma interesi të tregut.

4.7 Instrumentet financiare sipas kategorive

Vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë siç janë njohur në datën e bilancit të periudhës raportuese mund të kategorizohen edhe si më poshtë:

31 dhjetor 2016	**Kredi dhe llogari të arkëtueshme**	**Totali**
Aktivet sipas pasqyrës së pozicionit financiar		
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	103,997,163	103,997,163
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	6,078,811	6,078,811
	110,075,973	**110,075,973**

	Detyrime te tjera financiare me kosto të amortizuar	**Totali**
Detyrimet sipas pasqyrës së pozicionit financiar		
Huatë	2,758,793,345	2,758,793,345
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	1,006,844,017	1,006,844,017
	3,765,637,363	**3,765,637,363**

31 dhjetor 2015	Kredi dhe llogari të arkëtueshme	Totali
Aktivet sipas pasqyrës së pozicionit financiar		
Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme	97,846,055	97,846,055
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	3,390,902	3,390,902
	101,236,957	**101,236,957**

	Detyrime të tjera financiare me kosto të amortizuar	Totali
Detyrimet sipas pasqyrës së pozicionit financiar		
Huatë	2,763,821,493	2,763,821,493
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera të pagueshme	925,289,221	925,289,221
	3,689,110,714	**3,689,110,714**

5 Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë, që përshkruhen në Shënimin Nr. 3 të këtyre pasqyrave financiare, drejtimit i kërkohet që të bëjë gjykime, çmuarje, dhe supozime për vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë qartësisht të dukshme nga burime e tyre. Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to janë të bazuara në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto çmuarje.

Çmuarjet dhe supozimet e lidhura me to rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Ndryshimet në çmuarjet kontabël do të njihen në periudhën në të cilën çmuarja është rishikuar në qoftë se rishikimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe në periudhat e ardhshme në qoftë se rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhme.

Pasiguria ne gjykime

Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Humbjet nga zhvlerësimi njihen me shumën me të cilën vlera kontabël e aktiveve ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Kur përcaktohet vlera e rikuperueshme, drejtimi vlerëson çmimet e pritshme dhe flukset e parasë nga çdo njësi gjeneruese të mjeteve monetare dhe përcakton një normë interesi të përshtatshme kur llogaritet vlera aktuale e këtyre flukseve të parasë.

Jeta e dobishme e aktiveve të amortizueshme

Drejtimi rishikon në mënyrë të vazhdueshme jetën e dobishme të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Drejtimi vlerëson se jeta e dobishme e aktiveve reflekton dobishmërinë e pritur të këtyre aktiveve. Vlera e mbetur e këtyre aktiveve është analizuar në Shënimin Nr. 6. Megjithatë, rezultatet reale mund të ndryshojnë për shkak të konsumimit teknologjik.

5. Gjykime dhe vlerësime të rëndësishme kontabël- vazhdim

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve të tjera bazuar në humbjet e vlerësuara që rezultojnë nga paaftësia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën historike të nxjerrjes jashtë librave kontabël, cilësinë e klientit dhe ndryshimet në termat e pagesës së klientit kur vlerësohet saktësia e humbjes nga zhvlerësimi për llogaritë e dyshimta. Kjo përfshin supozime për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, çregjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta se sa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani.

Inventarë

Inventari është paraqitur me vlerën më të ulet midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme. Gjatë përcaktimit të vlerës neto të realizueshme, drejtimi merr parasysh evidencat me objektive/ të dhënat e disponueshme për kryerjen e vlerësimeve.

6 Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri	Mjete transporti	Mobilie dhe orendi	Ndërtim në proces	Totali
Kosto							
Më 1 janar 2015	734,915,000	3,973,163,216	1,795,559,262	29,283,370	402,338,630	502,903	6,935,762,381
Shtesa	-	7,932,382	74,743,940	2,870,833	30,552,706	44,201,931	160,301,793
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(23,832,942)	(1,117,728)	(551,087)	-	(25,501,756)
Riklasifikim	-	-	44,221,248	-	-	(44,221,248)	-
Më 31 dhjetor 2015	**734,915,000**	**3,981,095,598**	**1,890,691,508**	**31,036,475**	**432,340,250**	**483,586**	**7,070,562,417**
Më 1 janar 2016	734,915,000	3,981,095,598	1,890,691,508	31,036,475	432,340,250	483,586	7,070,562,417
Shtesa	-	14,556,726	64,388,677	1,182,823	31,468,204	281,488	111,877,918
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	(24,189,960)	(2,526,986)	(547,643)	-	(27,264,589)
Riklasifikim	-	-	648,510	-	-	(648,510)	-
Më 31 dhjetor 2016	**734,915,000**	**3,995,652,324**	**1,931,538,735**	**29,692,312**	**463,260,810**	**116,565**	**7,155,175,746**
Amortizimi i akumuluar							
Më 1 janar 2015	-	(360,199,182)	(677,844,348)	(11,598,744)	(274,183,021)	-	(1,323,825,296)
Amortizimi i vitit		(81,426,315)	(332,258,384)	(4,348,935)	(118,547,668)	-	(536,581,303)
Nxjerrje jashtë përdorimit	**-**	-	248,979	29,424	28,428		306,831
Më 31 dhjetor 2015	**-**	**(441,625,498)**	**(1,009,853,754)**	**(15,918,255)**	**(392,702,261)**	**-**	**(1,860,099,768)**
Më 1 janar 2016	-	(441,625,498)	(1,009,853,754)	(15,918,255)	(392,702,261)	-	(1,860,099,768)
Amortizimi i vitit	-	(82,770,671)	(298,968,815)	(3,942,681)	(19,504,677)	-	(405,186,844)
Nxjerrje jashtë përdorimit	-		17,268,390	1,373,772	29	-	18,642,191
Më 31 dhjetor 2016	**-**	**(524,396,169)**	**(1,291,554,178)**	**(18,487,164)**	**(412,206,910)**	**-**	**(2,246,644,420)**
Vlera kontabël neto							
Më 1 janar 2015	**734,915,000**	**3,612,964,033**	**1,117,714,914**	**17,684,625**	**128,155,610**	**502,903**	**5,611,937,085**
Më 31 dhjetor 2015	**734,915,000**	**3,539,470,101**	**880,837,754**	**15,118,220**	**39,637,989**	**483,586**	**5,210,462,649**
Më 31 dhjetor 2016	**734,915,000**	**3,471,256,155**	**639,984,557**	**11,205,149**	**51,053,901**	**116,565**	**4,908,531,326**

Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, shoqëria nuk ka asnjë aktiv afatgjate material te vene si kolateral. Më 31 dhjetor 2016 dhe 2015, shoqëria nuk ka asnjë angazhim kontaktual për të blerë ndonjë aktiv afatgjatë material.

Vlerat kontabël të makinerive dhe mjeteve të transportit të blera me qira financiare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 ishin si më poshtë :

Vlera kontabël neto	Makineri	Mjete transporti	Total
Më 31 dhjetor 2015	62,564,768	5,086,106	67,650,873
Më 31 dhjetor 2016	105,473,753	3,856,030	109,329,783

7 Aktivet afatgjata jo-materiale

	Licenca	Programe kompjuterike	Totali
Kosto			
Më 1 janar 2015	66,878,628	58,015,875	124,894,503
Shtesa	4,074,750	20,168,041	24,242,790
Më 31 dhjetor 2015	**70,953,378**	**78,183,915**	**149,137,293**
Më 1 janar 2016	70,953,378	78,183,915	149,137,293
Shtesa	3,333,372	18,168,304	21,501,675
Pakësime	-	(924,119)	(924,119)
Më 31 dhjetor 2016	**74,286,750**	**95,428,100**	**169,714,849**
Amortizimi i akumuluar			
Më 1 janar 2015	(38,539,653)	(13,473,713)	(52,013,366)
Amortizimi i vitit	(357,628)	(26,213,403)	(26,571,031)
Më 31 dhjetor 2015	**(38,897,281)**	**(39,687,116)**	**(78,584,397)**
Më 1 janar 2016	(38,897,281)	(39,687,117)	(78,584,398)
Amortizimi i vitit	(8,863,486)	(23,791,767)	(32,655,253)
Më 31 dhjetor 2016	**(47,760,767)**	**(63,478,884)**	**(111,239,651)**
Vlera kontabël neto			
Më 1 janar 2015	28,338,975	44,542,162	72,881,137
Më 31 dhjetor 2015	32,056,097	38,496,798	70,552,895
Më 31 dhjetor 2016	**26,525,983**	**31,949,216**	**58,475,198**

8 Inventari

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Materiale mjekësore	108,554,341	105,971,548
Medikamente	22,355,748	17,063,237
Të tjera	1,566,392	1,487,395
Provizione	(42,437,084)	(31,537,084)
	90,039,396	**92,985,096**

9 Llogari të arkëtueshme dhe të tjera të arkëtueshme

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari të arkëtueshme		
Llogari të arkëtueshme, bruto	138,885,392	128,629,975
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(41,450,462)	(34,891,872)
Llogari te arkëtueshme neto	**97,434,930**	**93,738,103**
Të arkëtueshme të tjera		
TVSH i parapaguar dhe tatime të parapaguara të tjera	433,182	433,182
Parapagime	31,358,820	29,289,865
Të arkëtueshme të tjera	6,562,232	4,107,951
Total i arketueshme te tjera	**38,354,235**	**33,830,998**
Total i llogarive te arketueshme	**135,789,165**	**127,569,102**

Struktura e vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Jo me vonesë		
< 90 ditë	69,177,267	60,019,289
Me vonesë po jo të zhvlerësuara:		
91 - 180 ditë	3,625,564	5,136,442
181 - 360 ditë	1,822,627	8,682,857
> 360 ditë	22,809,473	19,899,515
Të zhvleresuara		
> 360 ditë	41,450,462	34,891,872
Totali	**138,885,392**	**128,629,975**

Lëvizjet në zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme janë paraqitur më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Gjendja më 1 janar	34,891,872	33,668,337
Humbje nga zhvlerësimi	6,558,590	1,223,535
Gjendja më 31 dhjetor	**41,450,462**	**34,891,872**

10 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari rrjedhëse në monedhë të huaj	1,512,082	660,840
Llogari rrjedhëse në monedhë vendase	2,467,894	1,352,935
Mjete monetare në arkë	2,098,834	1,377,128
Totali i mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre	**6,078,811**	**3,390,902**

Llogaritë rrjedhesë me banka vendase analizohen si më poshtë;

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Alpha Bank	45,451	44,406
Tirana Bank	149,199	523,148
Raiffeisen Bank	2,909,588	1,083,142
Banka Kombetare Tregetare	814,328	43,699
Banka Kombëtare e Greqisë	61,411	180,405
Banka Credins	-	139,949
Totali mjeteve monetare ne bankë	**3,979,977**	**2,014,749**

11 Kapitali aksionar

Më 31 dhjetor 2016 totali i kapitalit të nënshkruar të shoqërisë është 3,666,306,707 lekë (31 dhjetor 2015: 3,666,306,707 lekë). Kapitali i nënshkruar përbëhet nga 8.708.567,00 aksione me vlerë nominale 421 për aksion.

Struktura e kapitalit aksionar me 31 dhjetor 2016 është si më poshtë

2016	Kapitali i rregjistruar (000 LEK)	% e kapitalit
Diagnostic and Therapeutic Center of Athens Hygeia	3,666,306,707	100.00%
	3,666,306,707	**100.00%**

12 Huatë

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Huatë afatgjata		
Hua që mbartin interes nga bankat		-
Qira financiare	65,752,850	43,673,871
Hua që nuk mbartin interes nga palët e lidhura	191,079,990	193,976,640
	256,832,840	**237,650,511**
Huate afatshkurtra		
Hua që mbartin interes nga bankat	2,480,763,453	2,513,574,631
Qera finaciare	21,197,052	12,596,351
	2,501,960,505	**2,526,170,982**
	2,758,793,345	**2,763,821,493**

Më 16 dhjetor 2010, Shoqëria ka nënshkruar dy kontrata huaje për 10,000,000 euro secila me Bankën e Detit te Zi për Tregti dhe Zhvillim dhe me BERZH, të cilat ripaguhen me 32 këste të barabarta tremujore, duke filluar që nga data e pagesës së parë të interesit mbas vitit të parë të nënshkrimit të kontratës. Të dy huatë kanë një interes vjetor prej 6%. Më 16 shtator 2013, Shoqëria amendoi kontratat me Bankat e sipërpërmendura duke rritur interesin me 7.5% në vit dhe duke amenduar ripagesat në 21 këste të barabarta tremujore duke filluar që nga data e pagesës së parë të interesit mbas vitit të dytë të nënshkrimit të kontratës së amenduar. Sipas kontratës së amenduar, Shoqëria duhet të fillonte pagimin e principalit duke nisur nga data 21 shtator 2015. Shoqëria ishte në pamundësi të paguante kestet e pagueshme në datën 21 shtator dhe 21 dhjetor 2015. Shoqëria hyri në një amendim tjetër të kontratës me datë 24 prill 2016 për shtyrjen e pageses së principalit për një periudhë tjetër 2 vjecare. Normat e interesit u rritën ne 9.5 % (5% paguhet në datat e pagesave dhe 4.5% kapitalizohet). Në datat e pagesave Shoqëria kryen pagesat për interesat në normën 5%, kurse 4.5% kapitalizohet në principalin e kredisë. Gjate vitit 2016, Shoqeëria ka kryer rregullisht pagesat sipas termave të kontratës së ndryshuar.

12.1 Qira financiare

Qiraja financiare analizohet si me poshte vijon:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Vlera më 1 janar	**56,270,224**	**20,475,899**
Qira financiare gjatë vitit	56,518,054	54,018,829
Paguar gjatë vitit	(25,838,375)	(18,224,504)
Vlera më 31 dhjetor	**86,949,903**	**56,270,224**

	Minimumi i pagesave të qerasë 2016	Vlera aktuale e minimumit të pagesave të qerasë 2016	Minimumi i pagesave të qerasë 2015	Vlera aktuale e minimumit të pagesave të qerasë 2015
Jo me shume se nje vit	26,996,292	21,197,052	17,117,292	12,596,351
1 deri ne 5 vjet	73,791,786	65,752,850	49,481,040	43,673,871
Me shume se 5 vjet	-	-	-	-
Te ardhura të pritshme nga interesi	(13,838,175)	**-**	(10,328,109)	**-**
Investimi neto ne qera financiare	**86,949,903**	**86,949,903**	**56,270,224**	**56,270,222**

13 Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogari të pagueshme		
Të pagueshme për palët e lidhura	-	-
Furnitorë të huaj	435,630,901	378,666,065
Furnitorë vendas	402,835,850	410,490,538
	838,466,752	**789,156,603**
Të tjera të pagueshme		
Paga të pagueshme	52,572,312	46,595,833
Detyrime të tjera	115,804,954	89,537,760
Sigurime shoqërore dhe tatimi mbi të ardhurat i pagueshëm	29,314,297	35,150,275
TVSH e pagueshme	1,942,588	2,318,914
	199,634,151	**173,602,781**
Totali	**1,038,100,902**	**962,759,384**

14 Shitjet

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shërbime të ofruara	2,264,717,201	2,016,691,535
Shitja e medikamenteve dhe e materialeve	464,671,255	442,896,420
Totali	**2,729,388,456**	**2,459,587,955**

15 Të ardhura të tjera

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kthime materialesh	577,307	(479,023)
Të ardhurat nga qiratë	21,874,418	22,265,324
Te ardhura te tjera	3,086,690	11,670,879
	25,538,415	**33,457,180**

Kthime materialesh jane kthime materialesh sanitare te shitura.

16 Kosto e mallrave dhe materialeve

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Materiale mjekësore	452,681,002	415,399,756
Medikamente	183,306,108	179,154,023
Të tjera	17,342,504	19,058,260
Totali	**653,329,614**	**613,612,038**

17 Shpenzime personeli

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Paga	766,406,837	728,573,472
Sigurime shoqërore	73,889,146	68,831,371
Shpërblime	2,929,145	1,729,600
Shpenzime të tjera personeli	6,740,137	6,778,875
Totali	**849,965,265**	**805,913,318**

18 Shpenzime të tjera operative

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Materiale dhe sherbime	644,677,822	525,261,562
Riparime dhe mirembajtje	81,104,325	103,872,210
Shpenzime, energjie, uji, gazi	96,881,145	95,200,391
Shpenzime sigurimi	37,966,478	34,814,359
Shpenzime te tjera	28,928,581	19,946,659
Shpenzime provizioni inventar	10,900,000	13,806,661
Marketing dhe promocione	39,039,918	51,748,856
Shpenzime transporti	29,036,560	46,970,808
Tarifat e drejtimit	10,768,808	12,838,919
Gjoba dhe penalitete tatimore	5,188,849	9,803,317
Shpenzime telekomunikacioni	8,530,838	10,157,889
Shpenzime bankare	12,396,942	10,785,675
Shpenzime qeraje	8,003,758	6,853,985
Totali	**1,013,424,023**	**942,061,291**

19 Të ardhura/ (shpenzime) financiare neto

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kosto financiare		
Shpenzime interesi	(211,617,713)	(189,201,601)
	(211,617,713)	**(189,201,601)**
T; ardhura të tjera financiare		
Fitimineto nga diferenca nga kursi i këmbimit	41,449,116	79,751,435
Totali i shpenzimeve financiare	**(170,168,597)**	**(109,450,166)**

20 Tatim fitimi

Shpenzimi për vitet që mbyllen me 31 dhjetor 2016 dhe 2015 mund të rakordoje me fitimin në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Humbja përpara tatimit	**(376,361,092)**	**(542,367,549)**
Shpenzime të pazbritshme për qëllime fiskale:		
- Shpenzime përfaqësimi	3,261,423	4,134,006
- Shpenzime udhëtimi dhe dieta	1,566,452	1,706,554
- Provigjon i pazbritshme për qëllime fiskale	24,078,686	11,627,125
- Shpenzime administrative	10,770,808	12,877,759
- Shpenzime qiraje	8,003,758	6,853,985
- Shpenzime transporti	1,254,262	4,496,807
- Shpenzime për gjoba	5,188,849	11,308,056
- Shpenzime të tjera të pazbritshme për qëllime fiskale	13,456,998	16,837,544
Fitimi i tatueshëm neto për vitin	**(308,779,858)**	**(472,525,714)**
Humbje të sjella në avance për qëllime fiskale	**(1,859,892,726)**	**(2,170,439,284)**
Tatim fitimi i vitit (shpenzim) 15%	**-**	**-**

Humbjet tatimore për vitin aktual dhe vitet e kaluara nuk janë njohur si aktiv tatimor i shtyrë sepse nuk ka siguri që shoqëria do të gjenerojë fitime të mjaftueshme në tre vitet në vazhdim në mënyrë që të përdorë humbjet tatimore. Humbjet tatimore të panjohura në vitin e pritshëm të skadimit janë si më poshtë:

Vitet	Humbjet përpara tatimit	Humbje fiskale	Viti skadimit
2007	(12,782,657)	(12,410,870)	2010
2008	(23,222,677)	(21,650,375)	2011
2009	(108,351,539)	(72,736,590)	2012
2010	(858,420,261)	(563,074,955)	2013
2011	(1,169,013,167)	(889,856,815)	2014
2012	(950,983,200)	(812,285,135)	2015
2013	(680,689,078)	(589,721,062)	2016
2014	(1,050,123,473)	(853,393,570)	2017
2015	(542,367,549)	(472,525,714)	2018
2016	(376,361,092)	(308,779,858)	2019
	(5,772,314,694)	**(4,287,655,085)**	

21 Angazhime dhe detyrime të kushtezuara

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Angazhime për qiranë operative		
Brenda një viti	7,545,834	29,362,248
Mbas një viti por jo më shume se 5 vjet	7,545,834	58,724,496
Total	**15,091,668**	**88,086,744**

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Angazhime të tjera kontraktuale		
Brenda një viti	58,484,270	59,370,854
Mbas një viti por jo me shume se 5 vjet	99,080,316	126,407,424
Total	**157,564,587**	**185,778,278**

Çështje ligjore

Më 31 dhjetor 2016, ka disa çështje gjyqësore të ngritura kundër shoqërisë apo nga shoqëria. Shoqëria mendon se këto çështje do të zgjidhen në favor të shoqërisë. Për çështjet me rezultat të pasigurt, shoqëria ka krijuar një fond provigjioni.

22 Transaksione me palët e lidhura

Shoqëria ka pasur transaksione me palët e lidhura përgjatë rrjedhës normale të biznesit. Tabela më poshtë përmbledh qëllimet dhe gjendjet nga transaksionet me palët e lidhura:

	Të arkëtueshme	Detyrime	Të ardhura	Shpenzime
2016				
Singularlogic S.A.	-	59,536,664	-	25,123,922
Hygeia S.A. (shareholder)	-	285,849,285	-	18,544,228
Mitera Holdings S.A.	-	32,267,578	-	-
Y-Logimed (Alan Medical S.A.)	-	156,954,363	-	60,673,537
Beatific S.A.	-	11,270	(511,020)	-
Alpha-Lab S.A.	-	8,927,208	-	4,541,486
		545,059,089	**(511,020)**	**108,883,172**
2015				
Singularlogic S.A.	-	40,691,766	-	32,726,904
Hygeia S.A. (shareholder)	4,507,863	273,709,835	-	15,568,302
Mitera Holdings S.A.	-	32,756,734	-	-
Y-Logimed (Alan Medical S.A.)	-	113,193,384	-	81,166,452
Beatific S.A.	-	2,469,615	-	-
Alpha-Lab S.A.	-	6,568,848	-	5,492,175
Total	**4,507,863**	**469,390,181**	**-**	**134,953,833**

22 Transaksione me palët e lidhura - vazhdim

Kompensimi për Drejtimin e Lartë

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	52,705,207	46,961,440
Shpenzime për sigurime shoqërore	2,750,596	2,706,027
Shpërblime të drejtimit	10,768,808	12,838,919
Totali i kompensimeve për Drejtimin e Lartë	**66,224,611**	**62,506,386**

23 Ngjarjet pas datës së raportimit

Asnjë veprim rregullues apo ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur midis datës së raportimt 31 dhjetor 2016 dhe datës se autorizimit të këtyre pasqyrave financiare.

Grant Thornton

www.grantthornton.al